



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Detaje te ceshtjes penale me numer: 61015-01257-13-2023

Nr. i Ceshtjes	61015-01257-13-2023
Titulli i ceshtjes	Shteti Kundër [I Pandehur]
Dt. e Regjistrimit	5/24/2023 12:00:00 AM
Lloji i ceshtjes	HUMBJE E FUQISE SE PARABURGIMIT
Baza ligjore	N,X MATERIAL MBYLLUR GJITHSHKA ESHTË MARRE NGA SHKRESA PERCJELLESE E *****SE NR.5139 DT 24/05/2023
Statusi i ceshtjes	Mbyllur
Gjyqtari	MATILDA FETAU
Nr. i vendimit	13-2023-1899
Dt. e vendimit	19-07-2023

Informacion per palet e ceshtjes

Emri	Tipi
	Prokuror



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Shkallës së Parë e
Juridiksionit të Përgjithshëm
Elbasan

Nr. Vendimit	13-2023-1899
Dt. e vendimit	19-07-2023
Permbledhja e vendimit	
<p>Gjykatapasi shqyrtoi dhe vlerësoi në tërësi çështjen dhe provat e marra gjatëshqyrtimit gjyqësor dhe pasidëgjoi konkluzionet përfundimtare të palëve, që në thelb kërkuan:</p> <p>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, përfaqësuar nga prokurori ***** ***** <i>kërkoipranimin e kërkesës sipas objektit.</i></p> <p>Mbrojtësi Av.Areta Ruçi kërkoj: <i>“Dakord me shuarjen e fuqisë paraburgimit dhe për caktimin e mases së sigurimit.”</i></p> <p>Personinën hetim Mikhail Zorin: <i>“Dakord me avokatin.”</i></p> <p>Mbrojtësi Av.Sajmir Vishaj kërkoj: <i>“Pranimin pjesërisht të kërkesës duke konstatuar humbjen e fuqisë paraburgimit dhe rrëzimin e kërkesës për caktimin e mase të sigurimit, pasi nuk ka nevojë për hetim.”</i></p> <p>Personinën hetim Fedir Aplatov: <i>“Dakord me avokatin.”</i></p> <p>Mbrojtësi Av.Fatmir Lushi kërkoj: <i>“Jemi dakord pjesërisht me kërkesën. Të konstatohet shuarja e fuqisë së paraburgimit dhe hetimet të vazhdojnë pa mase të sigurimit.”</i></p> <p>Personinën hetim Svetlana Timofeeva: <i>“Dakord me avokatin.”</i></p>	



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Shkallës së Parë e
Juridiksionit të Përgjithshëm
Elbasan

Dispozitivi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN

-

Nr. 61015-01257-13 (353) Regj.Them

SHKURTIM VENDIMI

-

-
Me vendimin Nr.353 Datë 25.05.2023 të Gjykes së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan i cili nuk ka marrë formë të prerë ndër të tjera është vendosur,

Vendosi

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykes së Shkalles së Pare të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit për personat nën hetim **Mikhail Zorin, Fedir Alpatov dhe Svetlana Timofeeva.**
2. Konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit dhe shuarjen e masës së sigurimit "**Arrest në burg**" dhënë me vendimin **Nr.655** datë **24.08.2022** të Gjykatës së Shkalles së Pare të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, i zgatur me afat 3 muaj me vendimit **Nr.139** datë **24.02.2023** të Gjykatës së Shkalles së Pare të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për personat nën hetim **Mikhail Zorin, Fedir Alpatov dhe Svetlana Timofeeva.**
3. Caktimin e masës së sigurimit personal "**Arrest në shtëpi**" për personin nën hetim Mikhail Zorin duke u urdheruar personi nën hetim Mikhail Zorin të mos largohet nga banesa e marrë me qera me adrese: Pallati nr.96, Hyrja nr.I, Kati II, Apartamenti garsoniere nr.5, Rruga "Ferit



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm

Elbasan

Xhajko”, ish restorant Durresi, pallat ekzistues, (banesa e qeradheneses Lindita Pano), Bashkia Tiranë, të parashikuar nga neni 237 i Kodit Proçedures Penale.

4. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i personit nën hetim Mikhail Zorin nëse nuk mbahet i arrestuar apo i ndaluar për ndonjë shkak tjetër.
5. Urdhërohen Shërbimet e Policisë Gjyqësore te Komisarariatit të Policisë Nr.4, Tiranë, të kontrollojnë dhe verifikojnë zbatimin e këtij vendimi nga personi nën hetim Mikhail Zorin.
6. Caktimin e masës së sigurimit personal ndaj personin nën hetim Fedir Alpatov atë të **“Detyrimit për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore”** të Hënën e parë të çdo muaji në orën 10.00, tek oficeri i policisë gjyqësore Petrit Xhepi, i Njesisë Rajonale Antiterror Elbasan parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe caktimin e masës së sigurimit personal **“Ndalimi i daljes jashtë shtetit”** të parashikuar nga neni 233 i K.Pr.Penale për personin nën hetim Fedir Alpatov, biri i Mikhail dhe Ilona, i datëlindjes 30.10.1997, duke urdhëruar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të bëjë bllokimin e pasaportës dhe kartës së identitetit të këtij shtetasi.
7. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i personit nën hetim Fedir Alpatov nëse nuk mbahet i arrestuar apo i ndaluar për ndonjë shkak tjetër.
8. Caktimin e masës së sigurimit personal ndaj persones nën hetim **Svetlana Timofeeva** atë të **“Detyrimit për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore”** të Hënën e parë të çdo muaji në orën 10.00, tek oficeri i policisë gjyqësore Petrit Xhepi, i Njesisë Rajonale Antiterror Elbasan parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe caktimin e masës së sigurimit personal **“Ndalimi i daljes jashtë shtetit”** të parashikuar nga neni 233 i K.Pr.Penale për persones nën hetim Svetlana Timofeeva e bija e Valeri dhe e Lyudmila, lindur me 18.03.1989, duke urdhëruar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të bëjë bllokimin e pasaportës dhe kartës së identitetit të kësaj shtetase.
9. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i persones nën hetim Svetlana Timofeeva nëse nuk mbahet e arrestuar apo e ndaluar për ndonjë shkak tjetër.
10. Mospranimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit të personin nën hetimin Fedir Alpatov për shkak se ngelet pa objekt.
11. Të paguhen perkthyesja e gjuhes ruse dhe e gjuhes ukrainase sipas tarifave shteterore.
 1. Kunder këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesermja e njoftimit të vendimit të gjykatës.

U shpall në Elbasan, sot më datë 25.05.2023.



REPUBLIKA E SHQIPERISE

**Gjykata e Shkallës së Parë e
Juridiksionit të Përgjithshëm
Elbasan**

SEKRETARE

Anila Haskurti

MATILDA FETAU

GJYQTARE

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.